




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-408/14</u>
Nr. Utaq Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31.01.2014</u>
Nr. pages	Dpa



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11,12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-2423/13 dhe AKK-03-2424, për z. Skenderbe Hebibi – Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vitisë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2423/13 dhe AKK-03-2424, për Zyrtarin e lartë, z. Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vitisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznese private, , është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur zyrtari i lartë z. Hebibi është hetuar për situatë të mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nga ushtrimin i dy funksioneve të papajtueshme si Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vitisë, dhe si dhe person i autorizuar në bizneset private N.T.P.”Abi – As” dhe “Abi & As – Group “ Sh.P.K.

Pas dërgimit të njoftimit nga Komuna e Vitisë me nr. 03-318/14 dhe pas analizimit të gjendjes është konstatuar z. Skenderbe Hebibi nuk ushtron më funksionin e zyrtarit të lartë publik, prandaj pushojnë hetimet për konflikt interesi.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

